



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:242233

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06267873

2023:242234

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.Z nga fsh. R....-K.Shtime me nr. personal, të cilin e përfaqëson av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi me autorizim L.M., me objektin e kontestit kompensim i diferencës për licencim, vlera e kontestit 1328,4€, jashtë seancës, më dt. 08.10.2024 ka marrë këtë;

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Z nga fsh. R....-K.Shtime me nr. personal ..., kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna Shtimes-Drejtoria e Arsimit që paditësit N.Z: për periudhën nga data 01.02.2021-30.01.2023, për 24 muaj, nga 55.35€ për çdo muaj, t'ia kompensojë diferencën në emër të licencimit në shumën e përgjithshme prej 1328,4€ (njëmijë e treqind e njëzetë e tetë euro e katërdhjetë cent), me kamatë 8 % nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 134,00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET paditësi N.Z nga fsh. R....-K.Shtime që në afat prej 7 ditëve të paguajë taksën shtesë për padi në lartësinë prej 10,00€ (dhjetë euro), nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, më 09.11.2023, kanë ushtruar padinë kundër të paditurës, lidhur me çështjen e mos pagesës së diferencës në pagë që rrjedh nga e drejta e licencimit. Ka shtuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së dt. 01.09.2020, si mësimdhënës në SHFMU S. në R...., ka të kryer fakultetin e filologjisë në Prishtinë, dega letërsi dhe gjuhë shqipe dhe posedon diplomën me titullin profesor.

Ka kërkuar nga gjykata që të DETYROHET e paditura Komuna Shtimes-Drejtoria e Arsimit që paditësit N.Z: për periudhën nga data 01.02.2021-30.01.2023, për 24 muaj, nga 55.35€ për çdo muaj, me kamatë 8 % nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive t'ia kompensojë diferencën në emër të licencimit në shumën e përgjithshme prej 1328,4€ (njëmijë e treqind e njëzetë e tetë euro e katërdhjetë cent), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E paditura në përgjigje në padi të dt. 21.06.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se padia dhe kërkesëpadia janë të parashkuara, po ashtu edhe kontrata kolektive e arsimit e vitit 2021 me nuk është në fuqi. Ka shtuar se Komuna nuk ka mundur të krijojë vijë buxhetore për të kryer këto pagesa që i parasheh kontrata kolektive e arsimit. Për të gjitha këto arsye konsideron se padia dhe kërkesepadia nuk kanë baze ligjore. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës e dt. 01.09.2020 nr prot.05/337-150, diplomë bachelori e UP-Fakulteti i Filologjisë e dt. 23.07.2012 nr prot. 2306, listën e pagave të muajit qershor 2021, mars 2022, licencë e mësimdhënësit nr 100007407 e dt. 10.12.2012.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga provat e administruara shihet se paditësi dhe e paditura kanë lidhur marrëdhënie pune, gjë që për palët dhe gjykatën ky fakt nuk ka qenë asnjëherë kontestues gjatë shqyrtimit të çështjes, pasi që kjo çështje vërtetohet edhe nga vetë kontrata e punës së paditësit, të nënshkruar me të paditurën, me atë të së cilës është themeluar marrëdhënien e punës, ku paditësi është në cilësinë e mësimdhënësit-punëmarrësit ndërsa e paditura si punëdhënëse, vendi i punës SHFMU S. në R.....

Nga lista e pagave vërtetohet se paditësit ju ka paguar në emër të kualifikimit shuma prej 58.32€ për çdo muaj, ndërsa paga bazë e paditësit është 421 euro.

Nga licenca e lëshuar nga MASHT 100007407 e dt. 10.12.2012, vërtetohet paditësi është licencuar për të punuar në sektorin e arsimit.

Nga diplomë bachelori e UP-Fakulteti i Filologjisë e dt. 23.07.2012 nr prot. 2306, gjykata ka vërtetuar paditësi ka diplomë Bachelor në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë dhe ka marrë titullin profesor.

Sipas nenit 2, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës, është paraparë se: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”.

Sipas 90 të këtij ligji, është paraparë se: “1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Sipas nenit 4, parag. 2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”.

E po ashtu lidhur me këtë sipas nenit 3, parag.1, pika 1.8 i këtij ligji ka paraparë se shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim ”Kontrata kolektive është marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur” kurse me pikën.

1.11 të po këtij paragrafi është paraparë se “Kontrata e punës është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.

Me Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 i datës 29.08.2008 shprehimisht në pikën 4.3 parashihet se: “mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë një rritje page bazë prej 27%.

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 214/2023, i datës 09.10.2023, në pikën I. të tij ka paraparë se: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar duke llogaritur për paditësin i cila ka pagën bazë 421€ dhe shuma e kompensimit për licencim është $27\% = 113.67$ euro nga e cila janë paguar 58.32 euro dhe shuma e mbetur pa e paguar është 55.35 euro për 24 muaj, në shumën totale prej 1,328.4€. Andaj, nga të gjitha të lartcekurat dhe bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata ka vlerësuar se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në emër të diferencës së papaguar për licencim dhe se i njëjti është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të paditurit, e cila në këtë procedurë na paraqitet apo ka rolin e debitorit ndërsa paditësi atë të kreditorit.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket parashkrimit gjykata vlerëson se nuk ka parashkrim për shkak se padia është paraqitur më dt. 09.11.2023 ndërsa periudha është prej dt. 01.02.2021-31.01.2023 që dmth. brenda afatit 3 vjeçar.

Lidhur me kamatën u vendosë konform nenit 382 të LMD dhe Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452, par. 2 dhe 463 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, e të cilat shpenzime përfshijnë: për përpilimin e padisë në shumën prej 104,00€, si dhe për taksë gjyqësore shumën 30,00€.

Me pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, detyrohet paditësi që në afat prej 7 ditëve të paguajë taksën shtesë për padi në lartësinë prej 10,00€ (dhjetë euro), nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, konform UA të KGJK lidhur me unifikimin e taksave gjyqësore. Kjo pasi që paditësi e ka paguar shumën prej 20,00€ në emër të taksës, ndërsa vlera e kontestit është 1,328.4€.

Konform nenit 398 të LPK, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 08.10.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.